REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorëzuar / Primljeno/Prodato / Recieved/Delivery 04.12.2018 viti god year
Organ./Njësia / Organ./Jedinica / Org./Unit: SKPMSHCK
Nr.Prot. / Br.Pros. / Proj.No.: 7392/2018
Shtojca / Prilog / Appendix:
Sasia / Kolicina / Quantity: 114

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A nr.722/2018

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Hajzer Salihu-kryetar, Eshref Shabani dhe Shkëmb Manaj-anëtarë, me Sabile Avdyli-procesmbajtëse, kanë shqyrtuar ankesën me numër protokolli 6650/2018 të datës 07.11.2018, të parashtruar nga ankuesi Hemë Çoçaj me adresë banimi në fshatin Gjonaj në Prizren, kundër organit të punësimit-Komuna e Prizrenit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 04.12.2018, mori këtë

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër protokolli 6650/2017 e datës 07.11.2017, e parashtruar nga ankuesi Hemë Çoçaj.

II. Shfuqizohet Vendimi me nr.02-111/147319 i datës 16.10.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Prizrenit.

III. Vendimi hynë ne fuqi ne ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

A r s y e t i m

Komuna e Prizrenit, me datë 25.07.2018 ka shpallur konkursin e jashtëm me Nr.01-111-110677 për pozitën Drejtor i SHFMU "Zenun Çoçaj" në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi . Më datën 21.09.2018 Komuna e Prizrenit ka publikuar listën e kandidatëve të propozuar për Drejtor dhe Zëvendës Drejtor. I pakënaqur me njoftimin e datës 21.09.2018, ankuesi më datë 01.10.2018 ka parashtruar ankesën me nr.02-111/147319 dhe me datën 08.10.2018 plotësim ankesën me nr.02/111-150706 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prizrenit. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Prizrenit më datë 16.10.2018 nxjerr Vendimin me nr.02-111/147319 me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit. Ankuesi kundër Vendimit me nr.02-111/144789 të datës 16.10.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prizrenit, më datë 07.11.2018 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6650/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 6650/2018 të datës 07.11.2018 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Plotësim ankesa e datës 14.11.2018 me nr. protokolli 6817/2018; Formulari i regjistrimit të ankesës; Kopja e letërnjoftimit; Procesverbal i datës 01.11.2018 për dorëzimin e vendimeve të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimi me nr.02-111/147319 i datës16.10.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Prizrenit; Formulari E; Formulari për kërkesë apo ankesë i datës 08.10.2018; Formulari për kërkesë apo ankesë i datës 01.10.2018; Kopje për njoftim Kryetarin e Komunës me datën 08.10.2018; Kopje për njoftim Kryetarin e Komunës me datën 01.10.2018; e-mail i datës 21.09.2018; Formulari për kërkesë apo ankesë e datës 07.05.2018; Ekstrakt i datës 07.08.2018; vërtetim i datës 30.04.2018; Çertifikatë shëndetësore e datës 04.05.2018; Çertifikatë e datës 02.05.2018 e lëshuar nga Gjykata Themelore Prizren, Kontratë pune e datës 22.06.2018 me nr.01-112-105342; Kontratë pune e datës 10.11.2010 me nr.814-2/10; Vërtetim i datës 02.05.2018; Vërtetim i datës 19.02.2016; Vërtetim i datës 28.07.2015; Vërtetim i datës 28.07.2015 me numër protokolli 208/15; Vërtetim i datës 03.05.2018; Referencë e datës 03.05.2018; Diplomë e datës 30.03.2009 e Fakultetit të Edukimit – UP; Çertifikata e notave master e datës 22.07.2015; Aktvendim mbi licencimin e mësimdhënësit me nr.1012443; Licencë e mësimdhënësit me nr.100012443 prej datës 01.03.2013-01.03.2018; Rekomandim i datës 02.05.2018; Çertifikatë për Zhvillimin e kapaciteteve në udhëheqjen arsimore, 21 ditë 2012 GIZ; Çertifikatë e vitit 2014 nga USAID; Çertifikatë e vitit 2009; Çertifikatë e vitit 2008; Çertifikatë e vitit 2005; Procesverbal i datës 28.03.2014; Procesverbal i datës 11.02.2016; Procesverbali i datës 18.02.2016; Procesverbali i datës 31.05.2017 dhe Plani zhvillimor i shkollës-2018.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka konstatuar që ankesa e ankuesit Hemë Çoçaj ***është e pabazuar, sepse:***

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon që Komuna e Prizrenit gjatë zhvillimit të procedurës së rekrutimit për pozitën Drejtor i SHFMU "Zenun Çoçaj" ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të legjislacionit për shërbimin civil procedurale .

Kriteret dhe kushtet e përcaktuara në konkursin e shpallur për pozitën Drejtor i Shkollës Fillore të Mesme të Ultë "Zenun Çoçaj" në Komunën e Prizrenit, kanë qenë:

- *Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;*
- *Të ketë të kryer së paku arsimin universitar të nivelit themelor (së paku kualifikimi prej 240 ECTS/ 4 vite të shkollimit universitar), nga profilet e pranueshme për pozitën e mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencimin e mësimdhënësve dhe normativit mbi punësimin e kuadrit mësimor dhe rregullativës tjetër ligjore;*
- *Të ketë licencë të rregullt të mësimdhënësit ose të jetë në procedurë të licencimit;*
- *Të ketë të përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim dhe menaxhim e noterizuar ose e vërtetuar*
- *Të kenë se paku 3 vjet përvojë pune në arsim ose në institucion të arsimit.*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor se kandidati i pranuar nuk ka plotësuar asnjë nga kriteret e konkursit, dhe ka konstatuar se pretendimet ankimore janë të pabazuara, sepse Kolegji për shqyrtimin e ankesave gjatë mbikëqyrjes së procedurës, ka konstatuar se Komisioni Rekrutues ka shqyrtuar aplikacionet e kandidatëve dhe në bazë të Formularit "C" në listën e shkurtër ka përfshirë tre kandidatë si: Qazim Çoçaj, Hemë Çoçaj dhe Halim Rexhbeqaj të cilët i kanë plotësuar kriteret e konkursit në bazë të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr.08/2014 për Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe të Zëvendësdrejtorit të Institucionit Edukativo-Arsimor dhe Aftësues, ndërsa kandidati i cili nuk është përfshirë në listë të shkurtër nuk ka plotësuar kushtet e konkursit pasi që ka diplomë me 180 kredi.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar që Komisioni Rekrutues për vendin e punës Drejtor i Shkollës Fillore të Mesme të Ultë "Zenun Çoçaj" në Komunën e Prizrenit, ka rekomanduar kandidatin Qazim Çoçaj, i cili posedon: Diplomën me Nr. 16571 të datës 13.01.2011 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, me të cilën dëshmohet se më datë 27.02.2008 ka përfunduar studimet duke marr titullin "Profesor i Historisë", posedon licencën e mësimdhënësit me Nr. 100010034 të lëshuar nga MASHT me datë 01.03.2013, çertifikatën e lëshuar në shkurt 2016 nga Kosova Hope ku ka përfunduar programin "Ndërtimi i Kapaciteteve të drejtorëve të shkollave për përmirësimin e qeverisjes, menaxhimit dhe udhëheqjes së shkollës", dhe me këtë përvojë pune: në bazë të vërtetimit të datës 27.01.2016, nga 01.09.2005 deri më datë 31.08.2010 në pozitën Mësimdhënës në SHFMU "Zenun Çoçaj", nga viti 2010-vazhdon në pozitën Mësimdhënës në Shkollën e Mesme "Gjon Buzuku".

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, lidhur me pretendimet tjera ankimore të ankuesit ka konstatuar se janë të pa bazuara për faktin që e gjithë procedura e rekrutimit nga momenti i publikimit të konkursit deri në përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit, ka qenë në vëzhgim të Kolegjit të Këshillit i cili ka përgatitur raportin me rekomandim për aprovim të procedurës si të rregullt, dhe se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.11.2018 ka nxjerr Vendimin me Nr.345/2017, me të cilin ka miratuar raportin e Kolegjit për vëzhgim, duke konstatuar se Komuna e Prizrenit, në lidhje me procedurat e rekrutimit për pozitën Drejtor i Shkollës Fillore të Mesme të Ulët "Zenun Çoçaj", ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 08/2014 Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe të Zëvendësdrejtorit të Institucionit Edukativo-Arsimor dhe Aftësues

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Prizrenit, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 02-111/147319 të datës 16.10.2018, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L–149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike lidhur me zhvillimin e procedurës për pozitën Drejtor i Shkollës Fillore të Mesme të Ulët "Zenun Çoçaj" .

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në diapozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit, Hemë Çoçaj;
- Kryetarit të Komunës së Prizrenit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prizrenit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A nr.722/2018;

Hajzer Salihu
Kryetar i Kolegjit

Sabile Avdyli
Procesmbajtëse